

ANALIZË E SHKURTË  
**Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim?**  
*Qershor 2014, Prizren, Gjilan*

## PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	2
II. Metodologjia e hulumtimit.....	3
III. Të dhënat demografike.....	3
IV. Për projektin .....	4
V. Të gjeturat kryesore të hulumtimit .....	5
VI. Përfundimet.....	8
VII. Rekomandimet .....	9
EC Ma Ndryshe .....	10
KCIC.....	11
Shtojcë, Rezultatet me grafike.....	12

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Rritja e Pjesëmarrjes përmes Mediave Sociale”, i përkrahur financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Projekti SMILE i financuar nga Democratic Governance Thematic Trust Fund (DGTTF)*



## I. Hyrje

Ky raport shqyrton transparencën e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit në raport me të rinjtë. Analiza rrjedh nga hulumtimet e dyta të realizuara ndarazi me këtë kategori të shoqërisë, në këto dy komuna, në kuadër të projektit “Pjesëmarrja përmes medieve sociale”, që është zbatuar përgjatë 15 muajve të kaluar në komunën e Prizrenit dhe gjatë një viti në komunën e Gjilanit.

Të gjeturat e raportit kanë dalë nga anketimet e zhvilluara me të rinjtë e shkollave të mesme dhe universiteteve të Prizrenit e Gjilanit. Në këtë anketim kanë marrë pjesë nga 200 të rinj, prej të dyja komunave, që i janë përgjigjur pyetjeve në lidhje me funksionimin e pushtetit lokal, transparencën dhe përfshirjen e publikut dhe të rinjve në vendimmarrjen komunale, si dhe njohuritë e tyre mbi mekanizmat që janë ndërtuar nga projekti për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje përmes medieve sociale.

Në bazë të perceptimeve të rinjve të Prizrenit dhe të Gjilanit del se në disa sfera që lidhen me transparencën komunale, qeveria lokale e Gjilanit ka një përparësi të lehtë përballë Prizrenit, megjithëse trendet nuk dallojnë në përqindje të madhe

Anketimi i dytë mbi transparencën komunale tregon se 47.3 për qind të rinjve të Prizrenit nuk kanë njohuri për vendimmarrjen, derisa 43.8 për qind e të rinjve kanë njohuri. Një vit më parë 61 për qind e të rinjve të anketuar të Prizrenit janë deklaruar se nuk kanë njohuri për vendimmarrjen në komunë dhe 38 për qindëshi tjetër ka thënë se ka njohuri.

Ndërsa në Gjilan 46.5 për qind të rinjve të anketuar nuk kanë njohuri për vendimmarrjen në komunë, derisa në hulumtimin e parë 55 për

qind të rinjve janë deklaruar se nuk kanë pas njohuri të tilla.

Në lidhje me transparencën komunale, aktualisht 41.2 për qind të rinjve të Prizrenit mendojnë se Ekzekutivi lokal është mesatarisht transparent. Në anketimin e parë 38.5 për qind të rinjve prizrenas besonin se qeveria komunale është mesatarisht transparente.

Në Gjilan 43 për qind të rinjve të intervistuar mendojnë se qeveria komunale është mesatarisht transparente, derisa një vit më parë 46 për qind të rinjve gjilanas besonin se qeveria lokale është mesatarisht transparente.

Në përgjithësi, rezultatet e hulumtimit tregojnë se në disa aspekte të përfshirjes së rinisë në vendimmarrje si dhe në transparencë ka përparim, në disa segmente ka stagnim, ndërkohë që mediat sociale po zënë vend gjithnjë e më tepër në jetesën e përditshme, trend i cili duhet të përcillet edhe nga institucionet lokale në komunikimin e tyre me publikun.

Në këtë drejtim komunat e Prizrenit dhe të Gjilanit nuk kanë dëshmuar përkushtim të theksuar, ngase organet dhe zyrtarët përgjegjës nuk kanë treguar ndonjë qasje proaktive në drejtim të rritjes së transparencës apo përfshirjes së të rinjve, aq më pak duke i përdorur mediat sociale, si mjete shtesë dhe më efikase për komunikimin me publikun.

Megjithatë gjatë zbatimit, projekti ka arritur që të prodhojë disa rezultate modeste, që mund të shërbejnë si udhërrëfyese për zhvillime më pozitive në drejtim të përdorimit të medieve sociale si mjete për pjesëmarrje dhe transparencë në nivel lokal, nga komuna dhe shoqëria civile.

Më pak se një vit pas futjes në përdorim, mbi 18 për qind të respondentëve të Prizrenit kanë njohuri për mundësinë e përcjelljes së vendimmarrjes komunale përmes medieve sociale si dhe ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org)

Në Gjilan, 7.5 për qind të respondentëve kanë njohuri për përcjelljen e vendimmarrjes përmes medieve sociale si dhe ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org)

Më shumë se çereku apo 28.6 për qind të anketuarve në Prizren, e dinë se mund të iniciojnë peticione online, duke shfrytëzuar platformën e ofruar për këtë destinim në kuadër të kësaj ueb faqeje. Edhe në Gjilan çereku i të anketuarve e dinë se tani mund të iniciojnë peticione online.

Ndërkohë në Prizren 14.8 për qind të respondentëve kanë njohuri se ankesat e tyre në raport me qeverisjen komunale mund t'i adresojnë në rubrikën “Ankohu” brenda ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org). Në Gjilan numër më i madh i të rinjve janë në dijeni për këtë mundësi, respektivisht 22 për qind të respondentëve.

Në anën tjetër 10.3 për qind të anketuarve prizrenas e dinë se mund të japin propozime për listën e projekteve kapitale të komunës, në kuadër të rubrikës “Buxheti me pjesëmarrje” në këtë ueb faqe. Ndërsa në Gjilan 18.5 për qind të anketuarve kanë njohuri për këtë mundësi të re.

Në përgjithësi, këto rezultate të dala nga perceptimi i të rinjve prizrenas dhe gjilanas mund të konsiderohen të arritura, nëse merret parasysh edhe fakti se 12 muajshi i kaluar ka qenë një periudhë intensive parazgjedhore, pasi që zgjedhjet komunale dhe ato nacionale kanë dominuar diskursin publik.

Por njëkohësisht janë edhe tregues se institucionet lokale dhe shoqëria civile duhet të kenë angazhim konstant dhe komunikim të rregullt me ta, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje. Kushti themelor për këtë është qeverisja demokratike e bazuar në transparencë proaktive.

## II. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi ka përfshirë anketimin e 200 të rinjve në komunën e Prizrenit dhe 200 të rinjve në komunën e Gjilanit. Mostra është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, me anketimin e çdo të pestit. Hulumtimi është kryer në hapësirat shkollore e universitare përkatësisht në oborret e tyre dhe në rrugë. Në Prizren 100 anketa janë kryer në katër shkolla të mesme, nga 25 në secilën, 50 në universitet publik e privat apo nga 25 në secilën dhe 50 të tjera në rrugë. Shpërndarja e njëjtë është ndjekur edhe në Gjilan. Margjina e gabimit është rreth dy përqind (+ ose -). Të rinjtë janë pyetur për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e pushtetit lokal, transparencën dhe përfshirjen e publikut dhe të rinjve në vendimmarrjen komunale.

## III. Të dhënat demografike

Prizren:

Gjinia: 48.8 për qind të anketuarve janë të gjinisë mashkullore dhe 51.2 për qind i përkasin gjinisë femërore.

Arsimimi: Në mesin e respondentëve shumica kanë të kryer shkollën e mesme apo 60.6 për qind, 37.9 për qind kanë të kryer fakultetin, 1.5 për qind me shkollë të lartë.

Etnia: Shumica e të anketuarve apo 92.6 për qind prej tyre janë deklaruar shqiptar, derisa 5.9

për qind janë deklaruar si kosovarë, 1 për qind turq dhe 0.5 për qind boshnjakë.

Mosha: 66 për qind të respondentëve janë të moshës mes 16-20 vjeçar, 27.1 për qind të moshës 21-25 vjeçar, 1.5 % të moshës 26-30 vjeçar dhe 5.4 % të moshës 31-35 vjeçar.

Gjilan:

Gjinia: Gjysma e të anketuarve janë të gjinisë mashkullore dhe gjysma tjetër e gjinisë femërore.

Arsimimi: Në mesin e respondentëve shumica kanë të kryer shkollën e mesme apo 63.7 për qind, 23 për qind kanë të kryer fakultetin, 11 për qind me shkollë të lartë, 1.5 për qind me master dhe vetëm 1 për qind me shkollë fillore.

Etnia: Shumica e të anketuarve apo 77 për qind prej tyre janë deklaruar shqiptar, derisa 23 për qind janë deklaruar si kosovarë.

Mosha: 64.5 për qind të respondentëve janë të moshës mes 16-20 vjeçar, 19 për qind të moshës 21-25 vjeçar, 10.5 % të moshës 26-30 vjeçar dhe 6 % të moshës 31-35 vjeçar.

Hulumtimi njëkohësisht ka pas për qëllim të analizojë edhe ndjeshmërinë gjinore karshi pyetjeve që u janë parashtruar respondentëve. Megjithatë, rezultatet tregojnë që nuk ka dallime signifikante në aspektin gjinor ,të cilat do të mund të na shërbenin për analizë më të thuktë në këtë aspekt.

#### IV. Për projektin

Projekti “Rritja e pjesëmarrjes përmes mediave sociale” i mbështetur financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) është zbatuar në Prizren nga OJQ-ja EC Ma

Ndryshe. Në Gjilan projekti i njëjtë është zbatuar nga EC Ma Ndryshe në partneritet me KCIC-në. Hulumtimet me të rinjtë e Prizrenit dhe të Gjilanit janë kryer për nevojat e këtij projekti.

Qëllimi i projektit ka qenë që të inkurajoj të rinjtë e Prizrenit dhe të Gjilanit për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale dhe që përmes qasjes inovative dhe edukative t’ju lehtësoj atyre kuptimin e të drejtave qytetare dhe përgjegjësive. Për më tepër, projekti ka ngushtuar hendekun mes pushtetit lokal dhe të rinjve duke i mbështetur ata përmes aktiviteteve të ndryshme në terren dhe në komunitet, duke përdorur mjetet sociale që janë në dispozicion gjithnjë e më shumë.

Projekti është përqendruar në tri objektiva kryesore: i) Forcimin e komunikimit interaktiv dhe të drejtpërdrejtë midis pushtetit lokal dhe grupeve rinore; ii) Të rrënjosë një kuptim më të mirë nga të rinjtë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre qytetare duke zhvilluar dhe futur në përdorim mediat sociale, dhe iii) Të rris interesimin e publikut dhe kuptimin e të drejtave qytetare dhe përgjegjësive.

Për realizimin e këtyre objektivave është monitoruar puna e qeverisë komunale dhe është avokuar për çështjet që janë preokupim i të rinjve.

Një prej mekanizmave që ndihmon pjesëmarrjen përmes mediave sociale është Ueb Portali, i këtij projekti, në të cilin janë të shpalosur të gjitha të gjeturat e monitorimit, bashkë me Platformat Online, si: Buxheti me pjesëmarrje; Platforma për shprehjen e shqetësimeve, dhe Peticioni elektronik, ndërkohë që së fundi është krijuar edhe Platforma për Konsultimet Online.

Projekti ka krijuar edhe sms platformën përmes së cilës publiku informohet rregullisht në baza javore mbi vendimet dhe takimet publike të Komunës së Prizrenit.

Projekti ka ndihmuar të rinjtë në veçanti dhe qytetarët në përgjithësi në adresimin e shqetësimeve të tyre tek organet vendimmarrëse përmes përdorimit të mediave sociale, që do të thotë se edhe qeveria lokale ka përfituar, pasi që ka një komunikim interaktiv me qytetarin.

Normalisht mbetet që këto mekanizma të fuqizohen më tej, me shtimin konstant të përdoruesve, që gradualisht shkon kah rritja.

#### V. Të gjeturat kryesore të hulumtimit

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në disa aspekte të përfshirjes në vendimmarrje e transparencë ka përparim, në disa segmente ka stagnim, ndërkohë që mediat sociale po zënë vend gjithnjë e më tepër në jetesën e përditshme, trend i cili duhet të përcillet edhe nga institucionet lokale në komunikimin e tyre me publikun.


Në bazë të perceptimeve të rinjve të Prizrenit dhe të Gjilanit del se në disa sfera që lidhen me transparencën komunale, qeveria lokale e Gjilanit ka një përparësi të lehtë përballë Prizrenit, megjithëse trendet nuk dallojnë në përqindje të madhe. Kjo rrjedh edhe nga fakti se komuna e Gjilanit ka pas një angazhim më pozitiv në përditësimin e ueb faqes zyrtare të saj, derisa ky ritëm nuk është përcjellë nga organet lokale të Prizrenit.

Anketa e dytë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me transparencën komunale tregon se 47.3 për qind të rinjve të Prizrenit nuk kanë

njohuri për vendimmarrjen në komunë. Një vit më parë, në anketimin e parë 61 për qind të rinjve nuk kanë pas njohuri të tilla. Mirëpo asokohe 38 për qind të rinjve të Prizrenit e kanë ditur mënyrën e funksionimit të komunës, derisa tani kjo përqindje është 43.8 për qind, megjithëse tani 8.9 të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.


Anketa e njëjtë në Gjilan shpalos perceptimin se 46.5 për qind të rinjve të kësaj komune nuk kanë njohuri për vendimmarrjen në komunë. Në anketimin e parë, 55 për qind të rinjve gjilanas nuk kanë pas njohuri të tilla. Vitin e kaluar 43 për qind të rinjve të Gjilanit e kanë ditur mënyrën e funksionimit të komunës, derisa tani kjo përqindje është 38 për qind, krahas 15.5 për qind të anketuarve që kanë refuzuar të përgjigjen.

Aktualisht 41.2 për qind të rinjve të Prizrenit mendojnë se ekzekutivi lokal është mesatarisht transparent, në krahasim me 35.5 për qind të tyre që thonë se ka pak transparencë. Mirëpo 5.5 për qind e të anketuarve besojnë se ka shumë transparencë, përballë 14.8 për qindëshit që mendon se nuk ka aspak transparencë. Dhe 3 për qind prej tyre nuk kanë përgjigje në këtë pyetje. Në anketimin e parë 38.5 për qind të rinjve besonin se qeveria komunal është mesatarisht transparente, në



krahasim me 51 për qind të tyre që patën thënë se ka pak transparencë.

Në Gjilan 43 për qind të rinjve mendojnë se qeveria komunale është mesatarisht transparente, në krahasim me 40 për qind të tyre që thonë se ka pak transparencë. Por 6.5 për qind e të anketuarve besojnë se ka shumë transparencë, ndërkohë që 9.5 për qind prej tyre nuk e dinë përgjigjen në këtë pyetje. Në anketimin e parë 46 për qind të rinjve gjilanas besonin se qeveria komunale është mesatarisht transparente, në krahasim me 45 për qind të tyre që patën thënë se ka pak transparencë.




Prania e të rinjve në seancat vendimmarrëse të Kuvendit Komunal, ka vazhduar të jetë në nivel të ultë, pasi që 14.8 për qind e të rinjve të Prizrenit janë deklaruar se kanë marrë pjesë në seanca të organit përfaqësues komunal, derisa 84.7 për qind kanë theksuar se nuk kanë marrë pjesë në ndonjë mbledhje të tillë.

Trendi i ngjashëm është shpalosur edhe në Gjilan, ku 14 për qind e të rinjve të kësaj komune janë deklaruar se kanë marrë pjesë në seanca të organit përfaqësues komunal, derisa 82.5 për qind kanë theksuar se nuk kanë marrë pjesë në ndonjë mbledhje të tillë.

Në këtë pikë duhet theksuar se nëntë mujori i kaluar ka qenë periudhë elektorale, gjatë të cilës kohë janë mbajtur pak mbledhje të KK-ve.

Gjatë kësaj periudhe 45.3 për qind të rinjve të Prizrenit kanë qenë të informuar lidhur me mbajtjen e debateve publike, derisa vetëm 16.3 për qind e tyre kanë marrë pjesë në diskutime publike. Në Gjilan 46.5 për qind kanë qenë të informuar lidhur me mbajtjen e debateve publike, ndërkohë 23 për qind e tyre kanë marrë pjesë në to.

Ndërkohë afër 5 të rinj në mesin e njëqind të rinjve të Prizrenit kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet lidhur me hartimin e buxhetit, përkundër 91 të tjerëve që nuk kanë marrë pjesë dhe 4 të tjerëve që nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.




Në Gjilan tre në mesin e dhjetë të rinjve të Gjilanit kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet lidhur me hartimin e buxhetit, përkundër pesë të tjerëve që nuk kanë marrë pjesë dhe dy të tjerëve që nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Po ashtu në Prizren 23.2 për qind të rinjve kanë theksuar se komuna përmes debateve publike i ka konsultuar qytetarët gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, derisa 12.3 për qind kanë thënë se ueb faqja e komunës ka shërbyer

për këtë praktikë, derisa 59.1 për qind kanë shprehur qëndrimin se nuk janë konsultuar rreth këtyre çështjeve. Në Gjilan 23 për qind të rinjve kanë theksuar se komuna përmes debateve publike i ka konsultuar qytetarët gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, derisa 18 për qind kanë thënë se ueb faqja e komunës ka shërbyer për këtë praktikë, derisa 52 për qind kanë shprehur qëndrimin se nuk janë konsultuar rreth këtyre çështjeve.

Anketimi i dytë në Prizren ndër të tjera tregon se aktualisht 85.7 për qind të respondentëve nuk kanë pasur mundësi që problemet t'i paraqesin para kryetarit apo drejtorëve të komunës, përballë 8.4 për qind që kanë pasur një mundësi të tillë dhe 5.9 për qind që kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje. Një vit më parë 83.5 për qind të anketuarve nuk kanë pasur mundësi që problemet t'i paraqesin para kryetarit apo bashkëpunëtorëve të tij, 11.5 për qind kanë mundur ta bëjnë këtë dhe 5 për qind nuk janë përgjigjur.



Në Gjilan, aktualisht dy në mesin e 10 të rinjve kanë pasur rastin që të paraqesin problemet para kryetarit apo drejtorëve të komunës, derisa muaj më parë vetëm njëri në mesin e 10 të rinjve kishte mundur ta bënte këtë.

Sa i përket mjeteve që të rinjtë e Prizrenit i shfrytëzojnë për tu informuar me vendimet e

komunës, përsëri prijnë mediat ngase 53.7 për qind e të rinjve të anketuar si mekanizëm për t'u informuar me vendimet e komunës i shfrytëzojnë ato, derisa 11.3 për qind ueb faqen e komunës dhe 18.2 për qind mediet sociale si dhe ueb faqen [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org). Në Gjilan gjithashtu prijnë mediat ngase 48 për qind e të rinjve të anketuar si mjet për t'u informuar me vendimet e komunës i shfrytëzojnë Mediet, 28 për qind ueb faqen e komunës, 7.5 për qind mediet sociale si dhe ueb faqen [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org).

Ndonëse ueb faqja e projektit ([www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org)) është një mjet i ri, çereku i të anketuarve, në Prizren e Gjilan e dinë se mund të iniciojnë peticione online, duke shfrytëzuar platformën e ofruar për këtë destinim në kuadër të kësaj ueb faqeje.

Ndërkohë 14.8 për qind të respondentëve në Prizren kanë njohuri se ankesat e tyre në raport me qeverisjen komunale mund t'i adresojnë në rubrikën "Ankoku" brenda ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org), përballë 22 për qind të rinjve të Gjilanit që janë në dijeni për këtë mundësi.

Po ashtu në Prizren 10.3 për qind të anketuarve e dinë se mund të japin propozime për listën e projekteve kapitale të komunës, në kuadër të rubrikës "Buxheti me pjesëmarrje" në këtë ueb faqe, krahasuar me 18.5 për qind të anketuarve në Gjilan, që kanë njohuri për këtë mjet online.

## VI. Përfundimet

Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje që përbëjnë një të katërtën e popullatës në Prizren dhe në Gjilan vazhdon që të jetë një çështje sfiduese për qeveritë lokale, që duhet të shtojnë përpjekjet për qeverisje demokratike,



duke zbatuar praktikat e transparencës proaktive.

Bashkëpunimi i organeve komunale me shoqërinë civile dhe grupet rinore në këtë drejtim është i domosdoshëm dhe duhet të ndërtohet mbi themele të pavarura nga ndikimet politike, në mënyrë që të edukohen gjeneratat e reja për një qasje të re karshi pushtetit lokal, duke e mbajtur atë përgjegjës dhe llogaridhënës për vendimet e marra dhe menaxhimin e buxhetit komunal.

Efektet e para të projektit janë se përderisa një vit më parë 61 për qind të rinjve të anketuar në Prizren nuk kanë pasur njohuri për vendimmarrjen në komunë, ku numër tani është mbi 47 për qind. Në Gjilan vitin e kaluar 55 për qind të rinjve të anketuar nuk kanë pasur njohuri për vendimmarrjen në komunë dhe tani ky numër është mbi 46 për qind. Bazuar në këto perceptime mund të nxirret konstatimi se ka një përparim të lehtë, që duket shpresëdhënës, por që duhet të shoqërohet me përpjekje të mëtutjeshme për përmirësim më të madh.

Ndërkaq perceptimi mbi nivelin e transparencës në Prizren e Gjilan ka shënuar një ngritje shumë të lehtë në krahasim me periudhën paraprake, derisa prania e të rinjve në seancat vendimmarrëse të Kuvendit Komunal ka vazhduar të jetë në nivel mjaft të ultë.

Në këtë pasqyrim duket se ka ndikuar periudha elektorale dhe pas elektorale, e zgjedhjeve komunale dhe nacionale, gjatë të cilës kohë ka pasur shumë pak aktivitete në komunë, e mjaft pak vullnet për transparencë dhe përfshirje të publikut në vendimmarrje.

Megjithatë projekti ka arritur që të prodhoj disa rezultate modeste që hapin rrugën për zhvillime

pozitive në drejtim të përdorimit të medieve sociale si mjete për pjesëmarrje dhe transparencë në nivel lokal.

Vetëm një vit pas futjes në përdorim 18.2 për qind të respondentëve të Prizrenit kanë njohuri për mundësinë e përcjelljes së vendimmarrjes përmes medieve sociale si dhe ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org). Në Gjilan 7.5 për qind të respondentëve kanë njohuri për të njëjtën gjë.

Si në Prizren ashtu edhe në Gjilan më shumë se çereku i të anketuarve e dinë se mund të iniciojnë peticione online, duke shfrytëzuar platformën e ofruar për këtë destinim në kuadër të kësaj ueb faqeje.

Ndërkohë në Prizren afër 15 për qind të respondentëve kanë njohuri se ankesat e tyre në raport me qeverisjen komunale mund t'i adresojnë në rubrikën “Ankohu” brenda ueb faqes [www.merrpjese.org](http://www.merrpjese.org), derisa 22 për qind të rinjve gjilanas dinë për këtë mjet të ri online.

E mbi 10 për qind të anketuarve në Prizren dhe 18.5 për qind të anketuarve në Gjilan e dinë se mund të japin propozime për listën e projekteve kapitale të komunës, në kuadër të rubrikës “Buxhetimi me pjesëmarrje” në këtë ueb faqe.

Në përgjithësi, rezultatet e dala nga perceptimet e të rinjve prizrenas dhe gjilanas mund të konsiderohen të arritura, nëse merret parasysh edhe fakti se 12 muajshi i kaluar ka qenë një periudhë intensive parazgjedhore, pasi që zgjedhjet komunale dhe ato nacionale kanë dominuar diskursin publik.

Marrë në përgjithësi Komuna e Prizrenit duhet të bëjë përpjekje për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, duke zbatuar kornizën ligjore të hartuar për këtë qëllim dhe duke bashkëpunuar ngushtë me të gjithë akterët relevantë në këtë drejtim.



Transparenca dhe përfshirja në vendimmarrje përbëjnë hapin e parë drejt qeverisjes së mirë dhe efektive dhe si të tilla i sjellin dobi komunitetit dhe vet udhëheqësve komunal.

## VII. Rekomandimet

Me qëllim të përmirësimit të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje por edhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, rekomandojmë që, komuna e Prizrenit dhe Gjilanit:

- Të tregojnë gatishmëri për ndryshimin e mënyrës së vendimmarrjes në nivel lokal;
- Të zbatojnë UA 2008/09 të MAPL-së dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje;
- Të krijojnë kushte për përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit komunal;
- Të ofrojnë mbështetje për propozimet e dala nga konsultimet me grupet rinore;
- Të informojnë pjesëmarrësit e debateve publike mbi rezultatet dhe ndikimin e përfshirjes së tyre;

- Të aplikojnë metoda moderne për konsultim publik dhe pjesëmarrjen e publikut, duke vënë në përdorim edhe mediat sociale.

Të aplikojnë metoda moderne për konsultim publik dhe pjesëmarrjen e publikut, duke vënë në përdorim edhe mediat sociale;

-Të zhvillojnë mjete efektive të komunikimit, veçanërisht përmes medieve të reja me qëllim të rritjes së nivelit të pjesëmarrjes aktive të rinjve nga grupe të ndryshme të komuniteteve;

-Të shqyrtojnë mundësitë e paraqitjes së vendimeve dhe informatave relevante në mediet sociale si pjesë e strategjisë së marrëdhënies me publikun;

-Të përdorin teknologjitë e mediave sociale për të angazhuar publikun në dialogun qeveri lokale-qytetar dhe për ofrimin mundësisë së diskutimit dhe zhvillimit të politikave si dhe zbatimit të tyre.

-Të kuptojnë rëndësinë dhe potencialin që kanë mediat sociale si hapësirë për komunikim dhe mobilizim;

-Të krijojnë dhe promovojnë Facebook faqet, llogaritë në Twitter, të shkruajnë bllogje, etj.

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Trasparenca”,; 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).

### Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Organizata Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) është themeluar në vitin 2001 kurse është regjistruar më 8 janar të vitit 2002 me numrin 51011813. Në fillim, misioni i organizatës ka qenë që të krijojë paqe të qëndrueshme në Kosovë duke ndërlidhur të rinjtë e të gjitha komuniteteve të Kosovës në realizimin e projekteve të përbashkëta dhe në këtë mënyrë të tejkalojnë barrierat e krijuara nga e kaluara.

Nga vitin 2004, organizata ka transformuar misionin e saj. Kështu nga kjo periudhë, misioni i organizatës është të ngritë aktivizmin qytetar, forcojë ndjenjën e komunitetit dhe të promovojë qeverisje të përgjegjshme sikur edhe të mbështesë dhe zhvillojë iniciativat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e resurseve humane në Kosovë e në veçanti të rinisë Kosovare.

Në këtë mënyrë, caku kyç i projekteve të organizatës është rinia e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia nacionale, fetare, racore, etj. Në këtë mënyrë, organizata ka përcaktuar edhe programet e saj përmes së cilave synon të arrijë misionin:

- Demokratizimi i shoqërisë duke monitoruar/ avokuar institucionet qeverisëse,
- Edukimi jo formal i qytetarëve e në veçanti edukimi i të rinjve në fushën e krijimit të vendeve të reja të punës,
- Fuqizimi i Shoqërisë Civile dhe Rrjetëzimi me organizata të ngjashme me qëllim të realizimit të projekteve që tangojnë misionin e organizatës,
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

Deri më tani organizata ka realizuar në numër të madhe të projekteve (mbi 40), si lidere e tyre por edhe si partnere e organizatave të tjera nga Kosova dhe organizatave ndërkombëtare dhe këto projekte, pothuajse në tërësi, janë financuar nga organizatat/ donatorët ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë dhe jashtë Kosove. Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) vazhdon të jetë aktive duke realizuar projekte vetanake apo si partner i organizatave të tjera.







# **SHTOJCË**







## **Rezultatet me grafike**







**Shtojca I. Rezultatet me grafike për qytetin e Prizrenit , 2013/2014**

**Shtojca II. Rezultatet me grafike për qytetin e Gjilanit, 2013/2014**







Shtojca I. Rezultatet me grafike për qytetin e Prizrenit , 2013/2014














Shtojca II. Rezultatet me grafike për qytetin e Gjilanit, 2013/2014

